



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.65/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovica e Veriut, të paraqitur kundër anëtareve të QKN-KQZ, në Komunën e Ranillugut, për shkak të pjesëmarrjes së personave të paautorizuar në QKN, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 31.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa, ZP.Anr.65/2025 e datës 30.12.2025, parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë Veriore të paraqitur kundër anëtareve të QKN-KQZ, në Komunën e Ranillugut, për shkak të pjesëmarrjes së personave të paautorizuar në QKN, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me 30.12.2025 PZAP- i, ka pranuar ankesë ZP. Anr.65/29025, nga subjekti politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë Veriore, në të cilën thekson se me datë 29.12.2025, në ambientet e Qendrës Komunale për Numërimin e Votave filloi procesi i numërimit të votave dhe futjes në sistemin elektronik të numrit të votave për subjektet politike dhe kandidatët për deputetë. Tutje në ankesë thekson se në qendrën komunale për numërim në komunën e Ranilugut, vëzhguesit e Listës Serbe vunë re se në QKN kishin ardhur persona që u paraqitën si pjesëtarë të policisë së Kosovës, si dhe një person që u paraqit si prokuror, dhe se këta persona i thanë vëzhguesit të Listës Serbe, Nemanja Ristiçit, se ata posedojnë një dokument të cilin e kanë vetëm institucionet zyrtare dhe mbi bazën e të cilit, shënimi në fletëvotim në formën e një zemre rreth numrit ose korrigjimi i dyfishtë të cilën ata e caktuan, nuk është i lejuar dhe se këto fletëvotime janë të pavlefshme. Po ashtu në ankesë theksohet se në kërkesën e vëzhguesit tonë për të mos përjashtuar fletëvotimet, sepse kjo është përgjegjësi e anëtarëve të QKN-së dhe sepse ai dëshironte të shikonte se për çfarë bëhet fjalë dhe cila është ajo rregulla që e ka policia, policët nuk i lejuan të shikonte dokumentin e përmendur, por pa asnjë bazë

dhe të drejtë, disa dhjetëra vota të fituara nga Lista Serbe i shpallën të pavlefshme, duke shkelur ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe rregulloret e Komisionit Qendror Zgjedhor në fuqi. Bëhet fjalë për fletëvotime nga vendvotimi nr. 3501/01 dhe 3501/02. Koha e ngjarjes ishte midis orës 11-12, në tavolinën nr. 1 dhe nr. 2 në QKN.

Parashtruesi i ankesë kërkon që të shikohen regjistrimet e kamerave nga tavolinat e përmendura të numërimit në QKN të Ranilugut në kohën e përmendur, dhe që fletëvotime të rishikohen dhe të shpallen të vlefshme, sepse ato edhe janë të tilla, dhe se parashtruesi thekson se vetë kam qenë i pranishëm në numërim, nuk kishte vëzhgues të tjerë, thuhet në ankesë.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se lidhur me pretendimet e palës ankuese se këta persona i kanë thënë vëzhguesit të Listës Serbe, Nemanja Ristiçit, se posedojnë një dokument që e kanë vetëm institucionet zyrtare dhe se në bazë të tij, shënimi në fletëvotim në formë zemre rreth numrit ose korigjimi i dyfishtë që ata e kanë përcaktuar, nuk është i lejuar dhe se këto fletëvotime janë të pavlefshme. Pala pretendon se pa asnjë bazë dhe pa të drejtë, ata kanë shpallur të pavlefshme dhjetëra vota që i ka fituar Lista Serbe, duke shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret në fuqi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bëhet fjalë për fletëvotime nga vendvotimet nr. 3501/01 dhe 3501/02. Koha e ngjarjes është ndërmjet orës 11:00-12:00, në tavolinat nr. 1 dhe nr. 2 në QNV. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Ranilugut, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim (shih bashkangjitur përgjigjen e KKZ në komunën e Ranilugut). Në ambientet e QKN në Ranilug, më 29.12.2025, rreth orës 11:30 të paradites, erdhën dy zyrtarë të NJHP në Gjilan, përkatësisht ekipi hetimor, zyrtari i policisë [REDAKTUAR] me numër identifikimi [REDAKTUAR] dhe zyrtari i policisë [REDAKTUAR] me numër identifikimi [REDAKTUAR], me qëllim mbledhjen e provave për një çështje penale - shkelje e vullnetit të lirë të votuesve sipas nenit 210 të Kodit Penal. Ata mbikëqyren procesin e numërimit të votave në qendrën e numërimit në Ranilug, me qëllim verifikimin e dyshimeve për kërcënime dhe detyrim të qytetarëve për të votuar lirshëm. Në autorizimin e dhënë, thuhet se zyrtarët e policisë janë të detyruar të vënë një fokus të veçantë mbikëqyrjeje në identifikimin dhe evidentimin e fletëvotimeve, në të cilat shënohen simbole të tjera përveç atyre të zakonshme në rubrikën e subjekteve, p.sh. simboli i zemrës, vijat e ndryshme, pikat dhe simbole të tjera.

Pas prezantimit, dhe ndërsa procesi i numërimit të fletëvotimeve ishte duke vazhduar, ata udhëzuan anëtarët e ekipit të numërimit që t'i merrnin fletëvotimet e tilla mënjane dhe ti fotografonin nga ana e zyrtarit të tyre.

Anëtarët e ekipit të numërimit e kryen punën e tyre në përputhje me Procedurat e Numërimit të Votave të QKN-së dhe Doracakun e Numërimit. Gjatë numërimit u konstatua një numër i caktuar fletëvotimesh me simbolet e specifikuar nga prokuroria publike themelore, të cilat shkaktuan dyshime dhe u kualifikuan si të pavlefshme në përputhje me procedurat.

Vëzhguesi i lartpërmendur Nemanja Ristiçit nuk e regjistroi ankesën për këtë lloj numërimi në librin e evidencës për të dy vendvotimet, pra 3501/01 dhe 3501/02. Në bashkëngjitje të email-it, po ju dërgoj autorizimin e prokurorisë publike themelore KTR.1 nr. 288/2025, të lëshuar nga prokuroria publike themelore në Gjilan. Ne lidhje me pretendimet e palës ankuese se fletëvotimet me zemra ose me ngjyra të ndryshme janë shpallur të pavlefshme, në procedurën e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ, janë paraparë shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme dhe rastet kur fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm. (Shih procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim).

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante, siç janë; Mostra të fletëvotimeve të shënjuara, librin e evidencës në QKN, dhe prova të tjera të cilat do të mund të dëshmonin shkeljet e pretenduara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë gjen se

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e subjektit politik Lista Serbe, nuk janë te bazuara dhe si të tilla i refuzoj. Kjo për faktin se për faktin ankuesi nuk ka paraqitur asnjë prove e cila do të vërtetonte faktin se në QKN kishin ardhur persona të paaautorizuar që u paraqitën si pjesëtarë të policisë së Kosovës, si dhe një person që u paraqit si prokuror, dhe se këta persona i thanë vëzhguesit të Listës Serbe, Nemanja Ristiçit, se ata posedojnë një dokument të cilin e kanë vetëm institucionet zyrtare dhe mbi bazën e të cilit, shënimi në fletëvotim në formën e një zemre rreth numrit ose korrigjimi i dyfishtë të cilën ata e caktuan, nuk është i lejuar dhe se këto fletëvotime janë të pavlefshme, e po ashtu pa asnjë bazë dhe të drejtë, disa dhjetëra vota të fituara nga Lista Serbe i shpallën të pavlefshme.

Paneli nga përgjigja në ankesë e KQZ-së ka konstatuar se personat të cilët pretendohen se janë paraqitur në QKN janë zyrtarë policorë dhe hetes të autorizuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan, për këtë KQZ ka paraqitur dëshmi dhe atë autorizimin e prokurorisë PPN.Lnr.288/25. Zyrtarët policor- hetuesi kanë mbikëqyren dhe hetuar procesin e numërimit të votave në qendrën e numërimit në Ranilug, me qëllim verifikimin e dyshimeve për kërcënime dhe detyrim të qytetarëve për të votuar lirshëm, ku zyrtarët e policisë hetuar me fokus të veçantë mbikëqyrjeje në identifikimin dhe evidentimin e fletëvotimeve, në të cilat shënohen simbole të tjera përveç atyre të zakonshme në rubrikën e subjekteve, p.sh. simboli i zemrës, vijat e ndryshme, pikat dhe simbole të tjera. Procesi i numërimit të fletëvotimeve ka vazhduar, ata udhëzuan anëtarët e ekipit të numërimit që t'i merrnin fletëvotimet e tilla mënjane dhe ti fotografonin nga ana e zyrtarit të tyre. Anëtarët e ekipit të numërimit e kryen punën e tyre në përputhje me Procedurat e Numërimit të Votave të QKN-së dhe Doracakun e Numërimit. Gjatë numërimit u konstatua një numër i caktuar fletëvotimesh me simbolet e specifikuar nga prokuroria publike themelore, të cilat shkaktuan dyshime dhe u kualifikuan si të pavlefshme në përputhje me procedurat.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e subjektit ankues janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin nuk është vërtetuar sa ka pas persona të pa autorizuar në QKN. Veprimet e zyrtareve policorë kanë qenë kanë qenë në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj, me autorizim të prokurorit për shkak të dyshimeve të vullnetin e votuesit. Ndërsa Anëtarët e ekipit të numërimit kanë kryer punën e tyre në përputhje me Procedurat e Numërimit të Votave të QKN-së dhe Doracakun e Numërimit, ku janë konstatua një numër i caktuar fletëvotimesh me simbolet e specifikuar nga prokuroria publike themelore, të cilat shkaktuan dyshime dhe u kualifikuan si të pavlefshme në përputhje me procedurat.

Paneli vlerësoj se subjekti ankues përveç ankesës, për të vërtetuar pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së, nuk i ka mbështetur në prova.

Andaj, duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.65/2025 datë 31.12.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.